



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.226/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Afijete Sada-Gllogjani dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni duke vendosur përkitazi me ankesën e organizatës BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 17.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa organizates BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë me shenjen ZL.Anr. 226/2017 e datës 16.10.2017, me të cilën ka kërkuar që ti shqiptohet dënimi me gjobë subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 16.10.2017 nga organizata BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se subjekti politik PDK përmes promovimit të një spoti publicitar me përmbajtje politike ka përdorur një pjesëtar të FSK-së me qëllim të zhvillimit të fushatës zgjedhore. Për më tepër ka theksuar se në minutën 0:10-0:15 të sekuencave të gjirimit, një pjesëtar i FSK-së është përfshirë në video spot, pra e njëjta video është publikuar përmes faqes së rrjetit social Facebook të profilit të kryetarit nga radhët e subjektit politik PDK.

Sipas pretendimeve në ankesë këto veprime paraqesin shkelje të Kodit për Subjektin Politik, andaj ka propozuar që subjektit politik PDK ti shqiptohet dënimi maksimal me qëllim të parandalimit të shkeljeve të ngjajshme.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një video-inqizim (kohëzgjatja: 1.06) në lidhje me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) të datës 17.10.2017, thekson se pretendimet ankimore të organizatës BIRN dhe Internews Kosova janë të pa bazuara dhe nuk përbëjnë shkelje zgjedhore, sepse sekuencat e shfaqura në spotin e kryetarit Kadri Veseli nga radhët e subjektit politik PDK janë në përputhje me programin zhvillimor të këtij subjekti politik. Për më tepër ka theksuar, shfaqja e një pjesëtari të FSK-së nuk është pjesë e organizimit të veçantë të veprimtarisë së saj në shërbim të fushatës zgjedhore, sepse LQP-ja dhe Rregullat zgjedhore të KQZ-së përcaktojnë në mënyrë të qartë

se kategoritë e veçanta nuk mund të përdoren në mënyrë të organizuar për fushat zgjedhore dhe me qëllim të përfitimit të votave.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljet e pretenduara të Kodit të Mirësjelljes nga ana e subjektit politike PDK, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin elemente me përmbajtje të shkeljes të Kodit të Mirësjelljes pasi që nga video inqizimi shihet qartë se nuk kemi të bëjmë me veprimet e ndaluara të subjektit politik, të përcaktuara me nenin 33 të LZP-së.

Andaj duke u bazuar në arsyet e dhëna më lartë dhe në kuptim të nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Zl.Anr.226/2017 më datë 17.10.2017.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.